

Informacione mbi mjekimin me barna të infeksionit të fshehur (latent) të tuberkulozit

Ty të është konstatuar infeksioni i fshehtë i tuberkulozit. Mjeku yt trajtues të ka propozuar mjekim me barna. Qëllimi i mjekimit është të shkatërrojë bakteret e tuberkulozit që fshehën në organizëm dhe në atë mënyrë të parandalojë sëmurjen. Mjekimi me barna fillohet vetëm nëse ke dëshirë dhe zotohesh për t'iu përmbajtur mjekimit. Sipas Ligjit mbi pagesat e pacientit, ky mjekim është falas për ty.

Infeksioni i fshehur i tuberkulozit mjekohet me kombinimin e 1-2 barnave kundër tuberkulozit.

- Isoniacidi (Tubilysin®) 300 mg tableta
- Rifampicina (Rimapen®) 600 mg tableta ose
- Rifapentina (Priftin®) 150mg tableta

Gjatësia e mjekimit varet nga kombinimi i i barnave. Kura me barna zakonisht zgjatë 3 - 9 muaj. Barnat i përshkruajmë në poliklinikën e spitalit për t'i marrë ose në ndonjë barnatore të zonës, sipas marrëveshjes, ose me recetë dorëzimi në barnatoren e spitalit.

Përdorimi i njëkohshëm i barnave tjera dhe produkteve natyrale duhet të kihet parasysh, për shkak të ndikimeve të dëmshme eventuale. Për këtë arsye, është me rëndësi që t'i tregosh mjekut për të gjitha barnat që përdor.

Barnat mund të shkaktojnë ndikime të dëmshme.

Pjesa më e madhe e ndikimeve të dëmshme janë të lehta dhe ato kalojnë pas një kohe të përdorimit të barnave ose ndaj tyre mund të gjinden mënyra për lehtësim.

Rifampicina dhe rifapentina

- Urina, pështyma, djersa dhe lëngu i lotit marrin ngjyrë portokalli. Kjo nuk është e dëmshme, mirëpo thjerrëza të syve nuk bën të përdoren për shkak të ngjyritimit.
- Eficienca e pilulave kontraceptive dobësohet, për këtë arsye gjatë mjekimit me këto barna parandalimin e shtatzënisë duhet verifikuar edhe me metoda tjera.
- Mund të shkaktohen skuqje dhe kruarje të fytyrës ose të lëkurës së kokës nja 2-3 orë par marrjes së barnave rifampicinë. Kjo simptomë mund të trajtohet me preparate të antihistaminës.

Isoniacidi

- Mund të shkaktojnë dëmtim të lehtë të nervit periferik, i cili shfaqet si mpirje e duarve dhe këmbëve, si dhimbje ose si ndjesi therëse. Kjo parandalohet me anë të përdorimit të vitaminës B6.
- Mund të shkaktojë skuqje të fytyrës dhe kokëdhimbje, ndonjëherë rrallë të fikët. Kjo është pasojë e tyraminës dhe antihistaminës që përmbajnë disa materie ushqyese. Shmang këto: kaçkavallin, verën e kuqe, peshkun ton (tuna), sallamin.
- Akne-ja mund të përkeqësohet. Kjo mund të mjekohet me preparate lokale për trajtimin e aknes.
- Flokët mund të bien më shumë se zakonisht. Kjo gjë korrigjohet pas mbarimit të mjekimit.

Barnat kundër tuberkulozit mund të shkaktojnë infektimin e mëlçisë, për këtë arsye vlerat e mëlçisë i kontrollojmë nëpërmjet analizave të gjakut rregullisht përgjatë kohës së mjekimit.

- Si simptoma mund të jenë, mundimi, vjellja ose dhimbjet e barkut. Ngjyra e lëkurës dhe të bardhit të syve mund të bëhen të verdha. Infektimi i mëlçisë mund të jetë edhe pa simptoma dhe mund të vërehet në analizat e gjakut.
- Përdorimi i alkoolit shton rrezikun e zhvillimit të infektimit të mëlçisë. Shmang përdorimin e alkoolit gjatë kohës së mjekimit me barna.

Simptoma të lehta, kontakto mjekun trajtues për të bërë vlerësimin e gjendjes tënde:

- Ekzemë kruarse, urtikaria
- Mundim, bark-qitje (diarre) dhe mungesë të oreksit
- Mpirje të duarve dhe këmbëve, dhimbje ose therje (verifiko a ke marrë vitaminë B6)
- Çrregullimet e gjumit, depresioni, çrregullimet në përqendrim, marramendja.

Simptoma serioze, në rast të shfaqjes së këtyre, mjekimi me barna duhet të ndërpritet. Kontakto menjëherë mjekun trajtues ose shko në stacionarin e emergjencës:

- Vjellje ose dhimbje të forta të barkut
- Të bardhët e syve ose lëkura marrin ngjyrë të verdhë
- Temperaturë dhe ekzema
- Urinë ka më pak se zakonisht, ngjyra e urinës bëhet shumë e mbylltë
- Dobësimi i aftësisë së të shikuarit
- Ngërçe
- Halucinacione
- Mendime për vetëvrasje, ndryshime të fuqishme të disponimit mendor
- Gjakderdhje e pazakonshme nga mishi i dhëmbëve ose nga hunda.

Çka tjetër duhet ditur?

Me anë të mjekimit me barna mund të parandalohet zhvillimi i sëmundjes së tuberkulozit te shumica e atyre që kanë marrë këtë trajtim. Megjithatë është me rëndësi që të përcjellësh gjendjen tënde shëndetësore. Kontakto me mjekun nëse të shfaqet kollë për një kohë më të gjatë, këlbazë, të kollitura, humbje të oreksit, humbje të peshës, lodhje të madhe ose djersitje gjatë natës.

Më shumë rreth tuberkulozit: www.tuberkuloosi.fi